



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Junikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Junikut (Junik), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Junikut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Junikut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B1 Komuna e Junikut në 4 projekte kapitale kishe hyrë në obligime kontraktuale përtej mundësive buxhetore dhe në kundërshtim me LPP-në Neni 9, pika 3.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Junikut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Junikut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Junikut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Junikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Junikut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë të bëjnë me hyrjen në obligime kontraktuale në mungës të mjeteve të buxhetuara me ligj të buxhetit, zotime dhe nxjerrje të urdhërblërjeve me vonesë, dobësi në menaxhim të pasurive, dobësi në raportimin e obligimeve të papaguara. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me katër rekomandime, prej tyre një rekomandim i ri dhe tri rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Nënshkrimi i kontratave përtej vlerës së parashikuar të buxhetit

Gjetja

Sipas LPP-së Neni 9, pika 3 - Nëse autoriteti kontraktues është organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale. ZKF do të siguroj që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore, ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

1. Për projektin “Asfaltimi i rrugës lokale Junik - Jasiq”- kemi vërejtur që vlera e buxhetuar për tre vite ishte 135,000€, ndërsa kontrata ishte nënshkruar në vlerë 145,651€ me një diferencë prej 10,651€, më të lartë së vlera e buxhetuar.
Në Ligjin e Buxhetit për vitin 2021 nuk kishte fare buxhet me emërtimin e projektit “Asfaltimi i rrugës lokale Junik - Jasiq”, ndërsa në Ligjin e Buxhetit për vitin 2022 ka hyrë si projekt i ri mirëpo vlera totale e tij ishte 55,000€ duke i shtuar vlerën me kërkesë të aprovuar nga MF 80,000€ prej rezervës.
2. Bashkëfinancimi me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambienti (MEA) për projektin “Ndërtimi i ujësjellësit në lagjen Agim Ramadani” - vlera e parashikuar ishte 100,000€, prej të cilave MEA do të financonte vlerën 80,000€ ndërsa komuna e Junikut vlerën 20,000€. Me datën 20.05.2021, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinore dhe Infrastrukturës (MMPHI) kishte njoftuar Komunën e Junikut që janë ndërprerë të gjitha bashkëfinancimet të cilat më herët kishin qenë të përcaktuara me memorandum nga MEA (tani pas ndryshimit të qeverisë në MMPHI). Komuna e Junikut kishte nënshkruar deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së mjeteve dhe kontratën me datën 13.07.2021, që i bie afër dy muaj pasi ishte njoftuar nga MMPHI për ndërprerje të bashkëfinancimit. Vlera e kontratës së nënshkruar ishte 86,036€, e cila nuk kishte mjetet të aprovuara në ligjin e buxhetit.
3. Për kontratën ndërtimi i “Memorialit të Dëshmorëve të UÇK-së - Junik” bashkëfinancim me Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në vlerë 48,360€, kemi vërejtur që për pjesën e financuar nga Komuna në vlerë prej 18,360€ nuk kishte mjete të aprovuara në ligjin e buxhetit për vitin 2021.
4. Kontrata e nënshkruar në vlerë 14,314€ për “Ndërtimin e Parkut të Femijëve” ishte paraparë të financohet nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal me 10,264€, ndërsa 4,050€ nga Komuna. Procedurat e prokurimit ishin udhëhequr nga Komuna dhe gjatë testimit të tyre kemi vërejtur që për vitin 2021 nuk kishte mjete të ndara për këtë projekt.

Në katër projektet e lartë përmendura, kemi vërejtur që Zyrtari Kryesor Financar nuk i kishte nënshkruar deklaratën për disponueshmërinë e mjeteve, mirëpo ato ishin nënshkruar nga persona tjerë.

Mangësitë e përmendura më lartë kanë ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të projekteve.

Ndikimi Hyrja në obligime kontraktuale nga komuna përtej mundësive buxhetore dhe në kundërshtim me ligjin, mund të ndikojë dhe rrezikojë mbarëvajtjen dhe implementimin e projekteve sipas planifikimeve si dhe mund të krijojë kosto shtesë për komunën, duke e futur komunën në vështirësi të thella në përmbushjen e obligimeve të krijuara.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në mënyrë që nënshkrimi i kontratave të bëhet në përputhje me buxhetin e planifikuar dhe aprovuar, në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B2 - Zotimi dhe urdhërblerja me vonesë

Gjetja

Rregulla financiare Nr.01/2013, neni 22, përcakton hapat për procedim të pagesave, ku fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje (zotimi i mjeteve), të procedohet urdhërblerja, pastaj pranimi i mallit, pastaj pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Gjatë testimi të pagesave kemi vërejtur që zotimi dhe urdhërblerja ishin lëshuar pas pranimit të faturave. Këto raste janë si më poshtë:

- Në 2 raste zotimi i mjeteve dhe procedimi i urdhërblërjeve ishte bërë pas pranimit të faturës; dhe
- Në 4 raste urdhërblerja ishte lëshuar pas pranimit të faturës.

Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit dhe ekzekutimit të pagesave.

Ndikimi

Zotimi i mjeteve financiare dhe procedimi i urdhërblërjeve me vonesë vështirëson zbatimin e drejtë të kontratave dhe krijon paqartësi rreth urdhërësive për furnizim, shërbime apo fillim të punëve.

Rekomandimi B2

Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 15,752,588€, pasurive jokapitale është 29,090€, ndërsa stoqet ishin zero. Kemi testuar 49 mostra për teste substanciale si dhe të pajtueshmërisë në vlerë 485,742€.

Çështja B3 - Mangësi në regjistrat e pasurisë

Gjetja Sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë jofinanciare Nr.02/2013 neni 6 çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jofinanciare që i ka në menaxhim të saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Sipas nenit 22 pika 1 - zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore.

Dobësitë e identifikuara lidhur me menaxhimin e pasurive janë si në vijim:

- Komuna ende nuk ka larguar nga regjistri i pasurive kapitale veturat e shitura në vitin 2019 me ankand publik të cilat ishin jashtë përdorimit, përveç që kërkesa nga Komuna ishte bërë në MF me datën 28.12.2021. Megjithatë, këto pasuri ende figurojnë në regjistrin e pasurive të prezentuar në PFV;
- Vlera e pasurive nën 1,000€ e prezentuar në PFV në vlerën prej 29,090€ nuk përputhet me aneksin e pasyrave. Vlera e këtij aneksi është 109,900€ në të cilin janë të përfshira edhe stoqet apo materiali shpenzues. Si i tillë ky raport nuk përlogarit vlerën e amortizimit;
- Një pagesë në vlerë 639€ nuk ishte e regjistruar në regjistrin e pasurive nën 1,000€; dhe
- Për më tej, vlera e stoqeve në PFV ishte zero marrë parasysh që materiali shpenzues ishte përfshirë në aneksin e pasurive nën 1,000€.

Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar kjo çështje vazhdon të mbetet e njëjtë, komuna ende nuk kishte funksionalizuar kontrollet për menaxhimin e pasurisë. Gjithashtu, problemet me prezantimin e pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve, janë për arsye të mos azhurnimit të të dhënave me arsyetimin që nuk kishte kontratë për mirëmbajtje të sistemit e-pasuria nga MAP/MPB.

Ndikimi Mos azhurnimi i regjistrave si dhe mos zhvlerësimi i pasurive ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të regjistrit të pasurive dhe nga kjo rrjedhimisht ndikon që informatat e paraqitura në PVF të mos jenë të sakta.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj që është bërë azhurnimi i regjistrave të pasurisë kapitale si dhe përlogaritja e zhvlerësimit për pasurinë jokapitale

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2021, ishte 105,533€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2022.

Çështja A1 - Dobësi në raportimin e detyrimeve

Gjetja	<p>Neni 6, i Rregullores financiare 02/2013 për Raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore, kërkon që raportet e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore të dorëzohen në afatin prej 15 ditë pas përfundimit të muajit, për gjendjen e muajit paraprak.</p> <p>Gjatë testimit të raportimit dhe mënyrës së pagesave për obligimet e papaguara, ne kemi vërejtur që faturat e protokolluara nuk ishin raportuar në raportet mujore në MF. Këto janë vërejtur në 7 pagesa në vlerë 52,707€.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të kujdesit jo të duhur që faturat të raportohen me kohë.</p>
Ndikimi	Mos raportimi i obligimeve mujore ndikon në raportimin jo të drejtë si dhe rrit rrezikun që faturat të mos paguhen me kohë.
Rekomandimi A1	Kryetari duhet të siguroj funksionimin efikas të pikës së kontrollit që verifikon se faturat raportohen me kohë në raportin e obligimeve mujore në MF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,546,704	1,547,967	1,459,692	1,924,110	1,883,773
Grante Qeveritare - Buxheti	1,423,902	1,385,709	1,370,202	1,735,090	1,631,395
Financimi përmes huamarrjes	0	5,156	5,156	19,215	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	31,830	31,830	94,659	87,612
Të hyrat vetanake	122,802	122,802	52,504	75,146	91,862
Donacionet vendore	0	18	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	2,452	0	0	72,904

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 1,263€. Kjo rritje është rezultat i rritjes nga huamarrja 5,156€, të hyrave vetanake nga viti i kaluar 31,830€, dhe donacioneve 2,470€, ndërsa zvogëlimit të grantit qeveritar për 38,193€.

Në vitin 2020 Komuna e Junikut ka shpenzuar 94% të buxhetit përfundimtar ose 1,459,692€, me një rënje prej 2% krahasuar me vitin 2020. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,546,704	1,547,967	1,459,692	1,924,110	1,883,773
Pagat dhe mëditjet	1,147,799	1,114,762	1,114,762	1,169,345	1,110,999
Mallrat dhe shërbimet	172,900	172,918	172,167	207,055	170,608
Komunalitë	36,200	36,200	29,878	32,626	29,910
Subvencionet dhe transferet	30,500	30,500	21,550	40,500	30,500
Investimet Kapitale	79,305	193,588	121,334	474,585	541,756
Rezervat	80,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Zvogëlimi i buxhetit të Pagave dhe Mëditjeve në raport me atë fillestar ishte 33,037€. Fillimisht me rishikim buxhetor ishte rritur për 27,285€, ndërsa pastaj kishte zvogëlim për vlerën 60,322€. Shpenzimi ishte 100% e buxhetit në këtë kategori;
- Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve buxheti final ishte rritur në raport me atë fillestar për vlerën 18€. Kjo rritje ishte me vendime të Qeverisë, Nr. 11/52 të datës 29.12.2021. Në këtë kategori, shpenzimi ishte 100%;
- Buxheti përfundimtar i kategorisë së shërbimeve komunale nuk kishte ndryshime. Shpenzimi ishte 83% e buxhetit;
- Ngjashëm edhe buxheti përfundimtar për subvencioneve dhe transfereve, nuk kishte ndryshime buxhetore. Në këtë kategori shpenzimi ishte 71%; dhe
- Rritja në buxhetin e investimeve kapitale në raport me atë fillestar ishte për vlerën 114,283€. Kjo rritje ishte me vendimeve të qeverisë, rritje te granti qeveritar 33,698€, të hyrave vetanake dhe të bartura nga viti i kaluar 78,133€ si dhe donacioneve për vlerën 2,452. Shpenzimet në këtë kategori ishin 85% e buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga komuna në 2021 ishin në vlerë 139,621€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, leje ndërtimore, taksa administrative, nga participimet, nga ushtrimi i veprimtarisë etj.

Totali i të hyrave të arkëtuara gjatë vitit 2021, krahasuar me vitin e 2020 ishin më të lartë për 41% apo për 40,670€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	122,802	122,802	139,621	98,951	179,816
Të hyrat tatimore	69,553	69,553	89,599	61,375	72,283
Të hyrat jo tatimore	53,249	53,249	50,022	37,576	107,533

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 ka rezultuar në 6 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2021, 3 rekomandime janë zbatuar ndërsa në 3 rekomandime nuk kishte filluar zbatimin, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të siguroj që është bërë regjistrimi i të gjitha pasurive, sipas kërkesave të rregullores për regjistrimin e pasurisë.	Nuk ka pasur asnjë rast të tillë në vitin 2021	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin dhe shpenzimin e drejtë të parave publike sipas kriterevetë përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe kornizësligjore.	Nuk ka pasur asnjë rast të tillë në vitin 2021.	I zbatuar
3.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në mënyrë që nënshkrimi i kontratave të bëhet në përputhje me buxhetin e planifikuar dhe aprovuar, në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë	Edhe këtë vit kemi vërejtur çështje të ngjashme.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me rregullatfinanciare për shpenzimin e parave publike.	Edhe këtë vit kemi vërejtur çështje të ngjashme.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj që është bërë azhurnimi i regjistrave të pasurisëkapitale si dhe përlogaritja e zhvlerësimit për pasurinë jokapitale.	Edhe këtë vit kemi çështje e njëjtë të pasurive.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj funksionimin efikas të pikës së kontrollit qëverifikon se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore tëpërcaktuara me ligj.	Gjatë testimit nuk kemi vërejtur vonesa në pagesë.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Etika Co shpk, (Fatmir Mehmeti person i autorizuar në emër të kompanisë)



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Dobësi në raportimin e detyrimeve	Bazuar në nenin 5 të Rregullores financiare 02/2013 për Raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore pika 1, citoj “Sipas dispozitave të nenit 39, paragrafi 1, të LMFPP, obligim i vonuar për pagesë i organizatës buxhetore konsiderohet fatura e cila nuk është paguar 30 ditë pas pranimit të faturës” andaj konsideroj që asnjë prej faturave të cekura gjatë testimit tuaj nuk i kanë kaluar 30 ditë nga data e pranimit deri me datën e deklarimit të tyre. Ne si organizatë buxhetore kemi deklaruar në baza të rregullta për faturat e papaguara dhe për obligimet kontraktuale në dy raporte të ndara sipas afateve ligjore për raportimin e obligimeve të papaguara.	Komuna, ka dhënë sqarime dhe treguar rrethanat që kanë ndikuar gjendjen e konstatuar nga auditimi. Megjithatë, nuk ka ofruar dëshmi apo provë tjetër që e dëshmon një gjendje ndryshe nga ajo e konstatuar nga auditimi. Andaj gjetja dhe rekomandimi mbetet e njëjta.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. <u>1-180/4512</u>
Nr. i faq. <u>1</u>
Data <u>10/10/2022</u>

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Junikut, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit por kemi vetëm një koment lidhur me Çështjen A1, të Bashkangjitur ne Shtojcën I të Letër konfirmimit si dhe:
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


Z. Rizhdi Shehu
Kryetar i Komunës së Junikut
Data: 10. Qershor. 2022, Junik.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.